



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:232481

Datë: 22.12.2021

Numri i dokumentit: 02541636

PPP.nr.45/2021

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përmbarimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike të kreditorit Kompania Rajonale e Ujërave H. SH.A, Rr. nr.. P. , kundër debitorit Rr. H. G. me adresë në Rr. p/n Istog, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 1,390.07€, duke vendosur sipas propësimit te parashtruar nga ana e debitori me dt. 15.09.2021, kundër Urdhrit mbi Lejimin e Përmbarimit, jashtë seancës me datën 22.12.2021, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESËRISHT propësimi i debitorit Rr. H. G. nga Istogu, ashtu që:

II.SHFUQIZOHET PJESËRISHT Urdhri mbi Lejimin e Përmbarimit P.nr.1259/2019, i dt:09.10.2019, për periudhën kohore 01.01.2015 e gjerë më 31.12.2017 në shumë prej 126.10 €, dhe **OBLIGOHET** debitori Rr. H. G. nga Istogu, që kreditorit Kompania Rajonale e Ujërave H. SH.A me seli në P. , në emër të borxhit për shërbimet e ujësjellësit për periudhën kohore 31.01.2018 e gjer me 31.08.2019, t'ia paguaje shumën prej 1,263.97 €, të gjitha këto me kamat ligjore prej 8 % nga data 22.12.2021 e deri në pagesën definitive te detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Kreditori, Kompania Rajonale e Ujërave H. SH.A, Rr. Lekë Dukagjini nr.. P. , ka parashtruar propozim për përmbarim kundër debitorit Rr. H. G. me adresë në Rr. p/n Istog, për pagesën e borxhit lidhur me shërbimet e ujësjellësit për periudhën kohore 01.01.2015 e gjer me 31.08.2019, ne shume totale prej 1,390.07€, me kamat ligjore prej 8%, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të pa luajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të

kreditorit pranë Raiffeisen Bank , të gjitha këto të specifikuara në propozimin për përmbaerim të dt. 09.10.2019.

Përmbaeruesi Privat me Urdhrin P.nr.1259/2019, i dt:09.10.2019, e ka lejuar përmbaerimin sipas propozimit te kreditorit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësime me shkrim, kundër urdhrin mbi lejimin e përmbaerimit, me kërkesë qe të anulohet i njëjti si i pa bazuar me arsyetimin se kemi parashkrim të borxhit sipas nenit 360 par.1 nenpar.1.1 te LMD-së, po ashtu propozimi për përmbaerim është lejuar në kundërshtim me nenin 38 par.1 dhe 2 te LPP-së, pasi që nuk e ka specifikuar periudhën kohore për te cilën e kërkon borxhin dhe nuk e përmban numrin personal identifikues. Me tutje debitori shton se kreditori ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike pasi qe ndaj debitorit bën faturim të dyfishtë si amvisëri dhe si biznes, ku nuk mund të kuptohet se për cilën kategori e kërkon borxhin.

Kreditori, është njoftuar me prapësimin e debitorit si dhe me mundësin e parashtrimit te përgjigjes, mirëpo në shkresa të lëndës nuk ka dëshmi qe ka ushtruar përgjigje.

Gjykata Themelore në Pejë – Dega Istog, si përmbaerimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se të njëjtit është i bazuar pjesërisht. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit pjesërisht tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbaerimore, sipas të cilave do të pengohet përmbaerimi i lejuar nga përmbaeruesi privat.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës, si dhe sa i përket pretendimeve të debitorit rreth parashkrimit konform nenit 360 te LMD-së, për te njëjtat pretendime gjykata gjeti se janë pjesërisht te bazuara, për faktin se i tërë borxhi me të cilin ngarkohet debitori Rr. H. G. nga Istogu për periudhën kohore 01.01.2015 e gjerë më 31.12.2017, është borxh i parashkruar, konform nenit 360 par.1, për faktin se debitori nga transaksioni i kreditorit gjatë kësaj periudhe shihet se ka bërë disa pagesa paushallë mirëpo nuk ka dëshmi se këto pagesa janë bërë ne emër te borxhit paraparak apo ne emër te faturave për muajt vijues, dhe se me vet faktin se ndërmmjet kreditorit dhe debitorit nuk ka ekzistuar paraparakisht një marrëveshje për ri programim eventual te borxhit, këto pagesa nuk e ka bërë ndërprerjen e rrjedhjes se afatit te parashkrimit, konform nenit 368 te LMD-se.

Sa i përket borxhit për periudhën kohore 31.01.2018 e gjerë me 31.08.2019, gjykata, gjeti se i njëjti borxh është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim te borxhit te kreditorit, ne raport me debitorin për këtë periudhe kohore, referuar nenit 360, par.2 te Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077), parashihet qe afati i parashkrimit për çdo kërkesë të arritur gjate një viti, fillon të rrjedhë në fundin e atij viti, e qe në rastin konkret për te gjitha kërkesat e arritura në vitin 2018, afati i parashkrimit ka filluar te rrjedh me 01.01.2019, andaj nuk kemi kalim te afatit te parashkrimi për periudhën e sipër cekur, për faktin se

kreditori, propozimin për përmbarim e ka parashtruar me datën 09.10.2019, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077).

Po ashtu sa i përket pretendimeve të debitorit lidhur me atë se propozimi për përmbarim është lejuar në kundërshtim me nenin 38 par.1 dhe 2 të LPP-së pasi që nuk e ka specifikuar periudhën kohore për të cilën e kërkon borxhin dhe nuk e përmban numrin personal identifikues, të njëjtat pretendime gjykata i refuzoj si të pa bazuara pasi që përmbaruesi privat ka ndërmarr veprime rreth sigurimit të të dhënave rreth debitorit, ashtu siç parashihet në nenin 38 par.2 të LPP-së, kurse sa i përket periudhës kohore neni 38 par.1 i LPP-së, në mënyrë specifike e kërkon shumën e kredisë që kërkohet të realizohet, për me tepër nga transaksioni i konsumatorit qartë dihet edhe periudha e borxhit që e kërkon kreditori nga ana e debitorit e që është periudha 01.01.2015 e deri me 31.08.2019.

Kurse sa i përket pretendimeve të debitorit lidhur me atë se kreditori ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike pasi që ndaj debitorit bën faturim të dyfishtë si amvisëri dhe si biznes dhe nuk mund të kuptohet se për cilën kategori e kërkon borxhin, lidhur me pretendimet e lartcekura gjykata sqaron faktin se debitori lidhur me faturimin dhe kategorinë e faturimit duhet të drejtohet me kërkesë-ankesë të kreditori që të korrigjohen gabimet eventuale.

Lidhur me kamatën e aplikuar gjykata vepron konform nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së

Duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, gjykata përshtatshmërisht aplikoj dispozitat ligjore të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve.

Prandaj nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 3, 29 par.1.2 dhe par.3, 37, 38 par.1 dhe 2, 69, 71, 73 par 3 të LPP-së (Ligjit për Procedure Përmbarimore), në lidhje me nenin 360 par.1 dhe 2, 368 dhe 369, 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
PPP.nr.45/2021 dt: 22.12.2021

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga pranimi i të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa parashtrohet përmes kësaj gjykate.